

Edukimi special i hershëm i fëmijëve të vështirë

Ç'është edukimi special i hershëm (pedagogjik dhe mjekues) i fëmijëve të vështirë?

Me edukimin pedagogjik dhe mjekues të hershëm përfshihen fëmijët e moshës parashkollore, zhvillimi karakterisitik i të cilëve bie në sy dhe/ose fëmijët me të meta. Ky lloj edukimi kryhet nëpërmjet masave pedagogjike dhe mjekuese, me ç' rast vendoset kontakt edhe me prindërit si dhe me persona të tjerë përkatës, të cilëve u jepen këshilla dhe sugjerime të duhura se si t'i kryejnë detyrimet e veta të vështira, për t'i edukuar fëmijët e tyre. Edukimi special i hershëm i fëmijëve të vështirë përfshin: regjistrimin, diagnostifikimin, nxitjen e fëmijëve me të meta në zhvillim si dhe këshillimin e prindërve.

Cilët fëmijë kanë nevojë për edukim special të hershëm?

Me edukimin special të hershëm të fëmijëve të vështirë përfshihen të gjithë fëmijët e moshës parashkollore, zhvillimi motorik, emocional, social, në të folur dhe/ose shpirtëror i të cilëve është i rrezikuar, bie në sy ose është me të meta. Diagnostika pedagogjike dhe mjekuese jep vlerësim dhe e njofton qendrën e edukimit special të hershëm të fëmijëve të vështirë. Ajo është një qendër edukative që shërben për t'i nxitur fëmijët në funksion të zhvillimit të tyre si dhe për këshillimin e prindërve.

Si zhvillohet puna në qendrën për edukimin special të hershëm të fëmijëve të vështirë?

Në plan të parë qëndron nxitja e përgjithshme e fëmijëve. Me veprimtarinë e nxitjes së përgjithshme të fëmijëve nënkuptohen: sjellja, të folurit, lëvizjet, perceptimi, regjistrimi i raporteve të ndërsjella, kontakti me të tjerët, të qenët i pavarur dhe gjendja emocionale. Duke u dhënë fëmijëve gjëra dhe sende për të luajtur apo gjëra dhe sende përditshmërie, ata do të nxiten në përputhje me shkallën e zhvillimit të tyre. Me fëmijën punohet kryesisht në shtëpi, e pikërisht në rrethin e tij të besueshëm, por ngandonjëherë edhe në qendrën e shërbimit pedagogjik dhe mjekues, veç e veç apo në grupe. Edukatorja që merret me edukimin e hershëm të fëmijëve u ndihmon prindërve në edukimin dhe në nxitjen e fëmijës së tyre dhe diskuton për çështjet që kanë të bëjnë me sjelljen ose me ngecjen në zhvillim të fëmijës.

Për ta realizuar plotësisht objektivin dhe për ta nxitur sa më tepër fëmijën, është tejet e rëndësishme që ndërmjet prindërve dhe personelit të qendrës edukative (p.sh. edukatores, psikologut të shkollës, terapeutëve, mjekut) të ketë një bashkëpunim të ngushtë.

Për ta nxitur interesimin për regjistrimin dhe për kujdesin e edukimit të hershëm të fëmijëve me të meta në zhvillim, nevojitet një punë reklamuese.

Sa zgjat trajtimi i fëmijës në qendrën për edukim special të hershëm?

Kohëzgjatja e trajtimit varet nga shkalla e zhvillimit të fëmijës si dhe nga nevojat e prindërve. Trajtimi mund të zgjatë prej disa muajve deri në disa vite dhe përfundon kur fëmija hyn në shkollë. Edukimi special i hershëm i fëmijëve të vështirë kryhet rregullisht (përafërsisht 1 herë në javë) dhe bëhet me pëlqimin e prindërve.

Kush mund ta paraqesë fëmijën në qendrën për edukim special të hershëm për t'u konstatuar nevoja eventuale e trajtimit pedagogjik-mjekues?

Fëmijën mund ta paraqesin në qendrën e sipërthënë prindërit ose personat profesionistë me miratimin e prindërve. Fëmija mund të paraqitet në qendrën e lartpërmendur që nga lindja e deri në përfundim të vitit të parë parashkollor.

Kush e paguan edukimin special të hershëm të fëmijëve të vështirë?

Shpenzimet e konstatimit të gjendjes psiko-fizike të fëmijës dhe të kujdesit do t'i marrë përsipër sigurimi invalidor dhe Kantoni.